

Drejtor/ Drejtoria e Qendrës Operacionale - CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik " i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Drejtor/ Drejtoria e Qendrës Operacionale - CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Drejton, supervizon dhe koordinon të gjithë punën e drejtorisë dhe përgjigjet tek titullari i institucionit;
- Zbaton sistemin e vlerësimit vjetor të punonjësve në varësi;
- Monitoron punën e drejtorisë, sektorëve si dhe stafit që ka në vartësi;
- Tregon kujdes të veçantë në respektimin e afateve dhe të procedurave për kryerjen e punës së drejtorisë;
- Jep zgjidhje konkrete për problemet që ndeshen gjatë kryerjes së detyrës;
- Zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me drejtoritë e tjera të institucionit;
- Jep kontribut në përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, për sa i përket fushës së veprimit të Autoritetit;
- Drejtoria vepron në cilësinë CSIRT-it Kombëtar, së bashku me drejtoritë e tjera;
- Zbaton aktet ligjore e nënligjore që dalin në funksion të objektit të veprimtarisë së Autoritetit;
- Kryen analiza për dobësitë e konstatuara në fushën e sigurisë kibernetike;
- Siguron ndihmë dhe mbështetje metodike për operatorët përgjegjës në fushën e sigurisë kibernetike;

- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin kibernetik në infrastrukturën kritike në mënyrë proaktive;
- Në momentin e evidentimit të anomalive merr masa për reagim sa më të shpejtë dhe efikas, me qëllim parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve të mundshëm kibernetik;
- Kryen simulime të ndryshme incidentesh dhe sulmesh, me qëllim rritjen e kapaciteteve teknike dhe operacionale në nivel kombëtar;
- Ndërvepron me njësitë e tjera brenda dhe jashtë institucionit, për realizimin e detyrave dhe funksioneve të përgjithshme të Autoritetit.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

KËRKESAT E POSAÇME

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në profesion, nga të cilat jo më pak se 5 vjet në fushën e sigurisë kibernetike. Të ketë të paktën 3 vjet përvojë në menaxhimin dhe koordinimin e ekipeve të menaxhimit të sigurisë kibernetike.

Atësitë: Njohuri shumë të mira në fushën e sigurisë kibernetike, e lidhur kjo me detyrimet e autoritetit për realizimin e politikave dhe programeve lidhur me këtë fushë; Aftësi për të realizuar objektivat teknik, për të evidentuar sulmet dhe për të analizuar informacionet (*loget*), risqet dhe ndjekur masat e kundërmasat për mbrojtjen; Aftësi për të komunikuar në grup e për të përballuar situata kritike, si dhe shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; Aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi, prezantimi dhe punë në grup.

Të ketë aftësi drejtuese, menaxhuese dhe vendimmarrës; Njohuri dhe aftësi shumë të mira në koordinim, menaxhim konflikti, njohuri analizuese, si dhe të ketë aftësi me menaxhimin e stresit. Njohuri të gjera të fushës, të metodikave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen bazike dhe analitike; Aftësi për të integruar informacionin me politikën institucionale; Aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën institucionale; Aftësi për të vlerësuar dhe parashikuar pasojat.

Të ketë njohuri të thelluara në kornizat e ndryshme të informacionit dhe sigurisë kibernetike, si: ISO 27001, NIST CSF, duke përfshirë direktivat e BE-së lidhur me sigurinë, rregulloret dhe ligjet kombëtare; Njohuri në vlerësimet e rrezikut të sigurisë së informacionit; Aftësi të forta shkrimi, të nevojshme për përgatitjen e dokumenteve dhe raporteve.

Të njohë mirë gjuhën angleze.

Përbëjnë avantazh certifikimet profesionale: Certifikatë në administrim rrjetash (CCNA ose ekuivalent); menaxhim sistemesh: IT security, LINUX, (preferohet të paktën një nga certifikatat). Certifikim në administrim të sistemeve të sigurisë së informacionit (ISO 27001, ITIL ose të ngjashëm), Certifikimi profesional në një ose më shume fushat e sigurisë si: CISA/CISM/CISSP

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Teknikat e sulmeve kibernetike dhe aplikacioneve që përdoren për këtë qëllim;
- Njohuri mbi protokollet e rrjetave kompjuterike;
- Njohuri mbi metodat e sulmeve kibernetike;
- Njohuri mbi aplikacionet dhe platformat që përdoren për monitorimin e elementeve të Sigurisë Kibernetike;
- Njohuri mbi fushën e sigurisë së informacionit;
- Vlerësimin e dobësive dhe sigurinë e rrjetit;
- Vlerësimin e njohurive mbi teknikat e hetimit kibernetik (Forensic)
- Njohuri mbi sistemet kompjuterike dhe sistemet e operimit;

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (II-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 20.09.2023, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.